

MENDIM PAKICE

Unë, komisionere Xhensila Pine, relatores e trupit gjykues të subjektit të rivlerësimit, znj. Lindita Ziguri (Male), kam votuar kundër vendimit për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, duke parashtruar arsyetimin tim në pakicë, lidhur me kriterin e pasurisë, si vijon:

I. DEKLARIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT, ZNJ. LINDITA ZIGURI (MALE),

1. Apartamenti i banimit, me sip. 68.8 m², në rrugën “*”, Tiranë,** deklaruar në deklaratën *Vetting*: “*Apartament banimi me sipërfaqe 68.8 m², në Tiranë, blerë në vitin 2008 në shumën 38,000 euro, nga të cilat 30,000 kredi, 5,000 hua pa kontratë dhe pa interes nga A.Gj. (daja) dhe 3.000 kursime nga të ardhurat nga puna*”.

1.1. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar të ardhura nga puna në shumën 3,000 euro si burim krijimi për blerjen e apartamentit me sip. 63.8 m².

1.2. Në DPV-në e vitit 2008 subjekti nuk ka deklaruar të ardhura nga puna në shumën 3,000 euro, si burim krijimi për blerjen e apartamentit me sip. 63.8 m².

1.3. Çmimi i shitjes sipas kontratës së shitjes të datës 4.4.2008, midis palës shitëse “***” sh.p.k. dhe palës blerëse subjektit të rivlerësimit, ishte në shumën 38,000 euro.

1.4. Komisioni, në pyetëtorin II, i ka kërkuar subjektit saktësimin mbi mënyrën e pagesës për blerjen e apartamentit me sip. 63.8 m² dhe paraqitjen e dokumentacionit provues për to.

1.5. Subjekti ka sqaruar se: “*Në lidhje me shlyerjen e çmimit të shitjes, pati dakordësi me palën shitëse që paraprakisht të paguhej një këst dhe pjesa tjetër të shlyhej me kredi. Në datën 15.4.2008 është bërë pagesa e këstit¹ (9,000 euro)*”.

1.6. Subjekti ka bashkëlidhur në përgjigje të pyetëtorit mandatpagesën e datës 15.4.2008, në shumën 9,000 euro, në favor të shoqërisë “***”.

1.7. Referuar të dhënave të kontratës pagesa e këtij mandati është bërë në favor të një shoqërie, e cila nuk është palë e kontratës së shitjes së datës 4.4.2008, lidhur midis palës shitëse “***” sh.p.k. dhe palës blerëse subjektit të rivlerësimit.

1.8. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar huan në shumën 5,000 euro nga shtetasi A.Gj., si burim krijimi për blerjen e apartamentit me sip. 63.8 m².

1.9. Në zbatim të kërkesave të pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ndodhur para një marrëdhënieje të konfirmuar të huas, iu kërkua subjektit të rivlerësimit dokumentacioni ligjor provues për burimin e ligjshëm të të ardhurave të huadhënësit.

1.10. Nga analiza financiare e kryer për huadhënësit mbi dokumentacionin ligjor të depozituar nga subjekti në zbatim të nenit 32.2 të ligjit nr. 84/2016, duke mos marrë në konsideratë investimet që mund të jenë kryer nga personat e tjerë të lidhur, rezultoi se shuma e të ardhurave ishte thujse në të njëjtën vlerë me shpenzimet jetike për familjen e huadhënësit për 3 anëtarët.

1.11. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në paragrafin 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës subjektit iu kalua barra e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën, për sa më poshtë vijon:

- ka mospërputhje deklarimi lidhur me burimet e krijimit të pasurisë apartament, pasi në deklaratën *Vetting* subjekti ka shtuar burimin kursime me të ardhurat nga puna në shumën 3,000 euro.
- personi tjetër i lidhur, z. A.Gj., nuk provon me dokumentacion ligjor provues të ketë pasur të ardhura të mjaftueshme për të dhënë hua shumën 5,000 euro.

¹ Mandati nr. ***, datë 15.4.2008 për shumën 9,000 euro, lëshuar nga shoqëria “***”, me përshkrimin: “*Arkëtim pjesor “apartament”, rruga ****”.

- pagesa datë 15.4.2008, në shumën 9,000 euro është kryer në favor të shoqërisë “*****” sh.p.k., e cila nuk ishte pala shitëse e apartamentit.
- subjekti nuk ka pasur mundësi financiare për të përballuar shpenzimet në vitin 2008, duke rezultuar më një balancë negative, në shumën 1,006,828 lekë.

Në lidhje me huan në shumën 5,000 euro, si burim krijimi

1.12. Subjekti i rivlerësimit, me shpjegimet e sjella pas rezultateve të hetimit, ka paraqitur aktekspertimin kontabël, nga kontabli i miratuar M.R., me dëshmi nr. 823, datë 23.10.2000, regjistruar me NIPT ***, i cili ishte hartuar mbi këtë dokumentacion:

i) rezultate hetimi për subjektin Lindita Male (Ziguri);

ii) aneks 02- metodika e përdorur në analizën financiare për subjektin e rivlerësimit;

iii) të dhënat e shtetasve A. Gj. dhe B. Gj., për të ardhurat nga viti 2005 deri më 4.4.2008.

1.13. Referuar aktekspertimit janë shtuar në llogaritje të ardhurat dhe shpenzimet e dokumentuara për vitin 2005 dhe të ardhurat dhe shpenzimet për shtetasen B. Gj., për periudhën 2005 - mars 2008. Këto të ardhura janë bazuar në informacionin e dërguar nga subjekti (formularë të sigurimeve shoqërore) për periudhën 2001 - më 31.3.2008.

1.14. Sipas aktekspertimit, familja Gj. ka pasur mundësi për periudhën 2005–3/2008 të kursejë shumën 479,247 lekë, duke u shprehur se: “*Nëse kryhet analizë për periudhën paraardhëse para vitit 2005 do të rezultojë që qiradhënësi i ka pasur mundësitë financiare për të kursyer shumën 120,000 lekë, për t’i dhënë hua subjektit shumën 5,000 euro*”.

1.15. Në analizën e bërë nga eksperti është shtuar një person i familjes në të ardhurat e periudhës 2005 - 2008, por nuk është deklaruar/shpjeguar/llogaritur asgjë në lidhje me shpenzimet e pjesës tjetër të familjes, pasi ka rezultuar se familja ka pasur 6 persona dhe nga eksperti, për periudhën 2006 - mars 2008, këto shpenzime janë llogaritur për 4 persona, ndërsa në vitin 2005 janë llogaritur për 3.2 persona² dhe nuk janë pasqyruar pasuri/likuiditete/shpenzime të tjera të kryera nga familja e huadhënësit për periudhën e llogaritur.

1.16. Pas vlerësimit tërësor dhe individual të akteve shkresore dhe shpjegimeve të dhëna prej subjektit të rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit vlerësoj se, për sa i përket huas në shumën 5,000 euro, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të shpjegojë bindshëm dhe të provojë me dokumentacion ligjor provues mundësinë financiare të huadhënësve për të krijuar të ardhurat e përdorura për këtë hua, duke mos provuar se për to ishin paguar detyrimet tatimore, sipas parashikimeve të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016.

Në lidhje me shumën 3,000 euro, si burim krijimi

1.17. Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës lidhur me mospërputhjet e konstatuara mbi burimet e krijimit të pasurisë, ku të ardhurat nga puna në shumën 3,000 euro deklarohen vetëm në deklaratën *Vetting*.

1.18. Aktekspertimi bazohet në procesverbalin mbi deklarinë e subjektit të rivlerësimit në datën 21.3.2016, në ILDKPKI, ku shuma prej 312,472 lekësh deklarohet se është tërhequr në vitin 2007 dhe është përdorur si pagesë për blerjen në prill të vitit 2008 (*shtuar dhe 470 euro, kursyer në janar – prill 2008*).

1.19. Bazuar në dokumentacionin e referuar nga kontabilisti për pasqyrimin e të dhënave, llogaritjen e rezultateve dhe nxjerrjen e përfundimeve të aktekspertimit, nuk është marrë në konsideratë deklarimi periodike vjetor kryer nga subjekti i rivlerësimit për vitin 2007.

² Referuar të dhënave për shpenzimet minimale për konsum të ILDKPKI-së.

Nga verifikimi i **DPV-së së vitit 2007, dorëzuar në ILDKPKI në datën 28.3.2008**, në rubrikën “ndryshim të interesave privatë pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar shtesa/pakësime, mbi gjendjen *cash* në vitin 2007.

1.20. Mosdeklarimi i gjendjes *cash* në banesë, në datën 31.12.2007, në referencë të nenit 4 pika “d” të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003³, i ndryshuar, referuar nenit 32/5 të ligjit nr. 84/2016 dhe jurisprudencës të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, kjo shumë nuk mund të përfshihet në analizën financiare për të provuar mundësinë financiare të subjektit për të paguar çmimin e apartamentit me sip. 68.8 m², në Tiranë, në vitin 2008.

1.21. Subjekti i rivlerësimit, sa më sipër, nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës lidhur me pamjaftueshmërinë financiare në vlerën -1,006,828 lekë, për vitin 2008.

1.22. Subjekti i rivlerësimit nuk arriti gjithashtu të provojë të kundërtën e barrës së provës lidhur me pagesën e datës 15.4.2008, në shumën 9,000 euro, kryer në favor të shoqërisë “*****” dhe jo në favor të palës shitëse të apartamentit shoqërisë “*****”. Rezulton se, përveç pagesës së kësaj të dytë, pas disbursimit të kredisë dhe kalimit të kësaj shume në favor të shoqërisë ndërtuese, subjekti i rivlerësimit nuk ka dokumentuar asnjë transaksion tjetër të kryer prej saj me shoqërinë shitëse “*****”.

1.23. Bazuar në provat dhe faktet e analizuara së bashku edhe shpjegimet dhe provat e sjella nga subjekti i rivlerësimit arrij në përfundimin se, subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e krijimit të kësaj pasurie, në përputhje me paragrafin 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe ndodhet në kushtet e pamjaftueshmërisë në deklarim për kontrollin e pasurisë sipas nenit 33, pika 5, germa “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.

2. Shpenzimet e shkollimit të personit të lidhur, znj. D.M., në Paris

2.1. Në deklaratën *Vetting*, në seksionin e të dhënave konfidenciale, personi i lidhur, znj. D. M., ka deklaruar *gjendje cash e depozituar në llogarinë personale bankare pranë bankës “Societe Generale”, në Francë, për të mundësuar shpenzimet e jetesës gjatë periudhës së studimit në Francë, shtator 2013 – maj 2016. Burimi i të ardhurave është sponsorizimi prej xhaxhait, shtetasit B.S.M.. Shuma totale 26,010 euro.*

2.2. Ky deklarim, i pashoqëruar nga dokumentacion ligjor justifikues, nuk rezulton që të jenë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në disa nga deklaratat periodike vjetore, përkundrejt detyrimit që ka pasur ajo si subjekt deklarues, dhe në deklaratat periodike vjetore kur është deklaruar, nuk gjen mbështetje nga faktet e rezultuara nga hetimi administrativ.

2.3. Bazuar në nenin 2/7 të ligjit nr. 9049/2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar “Shpenzim i deklarueshëm” është tërësia monetare e paguar për arsim, mjekim shëndetësor, pushime, arredim, si dhe të tjera shpenzime të këtij lloji, të kryera nga subjekti deklarues”, dhe sipas nenit 4, germa “h” të këtij ligji, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin për deklarimin shpenzimeve kryer përtej vlerës 500.000 lekë përpara vitit 2014 dhe 300.000 lekë pas këtij viti.

2.4. Në DPV-në e vitit 2013, dorëzuar në datën 27.3.2014, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk kanë deklaruar të ardhura në formën e sponsorizimit/dhurimit, si dhe shpenzime për studime/jetesë jashtë vendit të vajzës së tyre D. M.

2.5. Në datën 30.7.2013 në llogarinë nr. 00001130715-20 në “Societe Generale Albania” të personit të lidhur, znj. D.M., është kryer një depozitim *cash* në shumën 7,500 euro me

³ Ligji nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, sipas të cilit subjektet detyrohen të deklarojnë *vlerën e likuiditeteve, gjendjen në cash jashtë sistemit bankar në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj.*

përshkrimin: “**B.M. derdhje cash**”, të cilat janë tërhequr *cash* nga personi i lidhur, vajza e subjektit, në datën 28.8.2013.

2.6. Kjo shumë nuk është deklaruar nga subjekti apo personat e lidhur në DPV-në e vitit 2013, as si e ardhur në formë sponsorizimi, dhe as si shpenzim për studime jashtë vendit. Mbas tërheqjes shuma nuk provohet të jetë transferuar apo të ketë shërbyer për pagimin e studimeve të vajzës së subjektit, gjatë vitit shkollor 2013-2014. Transaksioni duke u depozituar dhe tërhequr e njëjta shumë në një kohë të shkurtër, nuk provohet të mos jetë kryer si garanci për marrjen e vizës studentore nga vajza e subjektit në këtë periudhë.

2.7. Nga administrimi i korrespondencës elektronike, paraqitur në cilësinë e provës fletëdeklarata e shkëputur nga deklarata periodike vjetore DPV/2013, paraqitur nga subjekti në përgjigje të pyetësorit të tretë dhe deklarimet sipas procesverbalit të datës 21.3.2016 në ILDKPKI, nuk ka asnjë deklarim të subjektit apo personit të lidhur/ D.M. për shpenzime studimi në Francë, për vitin 2013-2014, apo deklarim mbi mbulimin e këtyre shpenzimeve nga pala e tretë, në shumën 7,500 euro, ndaj kjo vlerë nuk është marrë në konsideratë si sponsorizim për vitin shkollor 2013-2014.

2.8. Në DPV/2014, dorëzuar në datën 19.3.2015, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk kanë deklaruar të ardhura në formën e sponsorizimit/dhurimit, si dhe shpenzime për studime/jetesë jashtë vendit të vajzës së tyre D. M.

2.9. Në DPV/2015 në seksionin e të dhënave konfidenciale, shpenzimet e deklarueshme mbi 300,000 lekë, personi i lidhur, znj. D.M. ka deklaruar: “*kosto jetese për studime të larta në Francë, për vitin shkollor 2014 – 2015 sponsorizuar nga xhaxhai B.M., administrator i ‘***’ sh.p.k., me urdhërshirim në datën 19.8.2014, shuma 8,000 euro*”.

2.10. Ky deklarim gjen mbështetje në sa ka rezultuar nga informacioni i marrë nga hetimi administrativ, sipas të cilit në datën 19.8.2014 në llogarinë nr. **** në Bankën “Societe Generale Albania” të personit të lidhur, znj. D.M., është kryer një kreditim në shumën 8,000 euro me përshkrimin: “*** sh.p.k., sponsorizim për shkollë”, transferuar brenda ditës në favor të llogarisë së D. M. në Bankën “Societe Generale” në Francë, me përshkrimin: “*Living cost during the studies*”.

2.11. Për sa më sipër, referuar deklarimit të bërë në vitin 2015, i cili ka korrigjuar mosdeklarimin e bërë në vitin 2014, është marrë në konsideratë shuma e transferuar në gusht të vitit 2014, duke u konsideruar shuma prej 8,000 euro në analizën financiare të kryer për vitin 2014 – 2015, pavarësisht se nuk është provuar se sponsorizimi nga shoqëria ka pasur formën e duhur ligjore.

2.12. Referuar nenit 2 të ligjit nr. 7892, datë 21.12.1994, “Për sponsorizimet”, i ndryshuar, është përcaktuar se: “*mund të sponsorizohen veprimtaritë e parashikuara në nenin 1, të cilat kryhen nga ente, institucione, shoqata dhe organizma që janë të njohura me ligj dhe që janë të regjistruara si subjekte juridike*”. Në nenin 3 është përcaktuar: “*... sponsorizues në kuptim të këtij ligji janë vetëm subjektet që kanë cilësinë e tregtarit, qofshin këta persona fizikë, juridike vendas apo të huaj...*”. Në nenin 4 është përcaktuar: “*Çdo sponsorizim lidhet me një kontratë të lidhur midis sponsorizuesit dhe përfituesit. Kryerja e çdo sponsorizimi, në para a në natyrë dokumentohet në pajtim me legjislacionin tatimor kontabël e bankar në fuqi*”.

2.13. Në DPV/2016 në seksionin e të dhënave konfidenciale, shpenzimet e deklarueshme mbi 300,000 lekë, personi i lidhur, znj. D.M. ka kryer deklarim: “*Kosto jetese për studime të larta në Francë, për vitin akademik 2015 – 2016, sponsorizuar nga xhaxhai B.M., administrator i ‘***’ sh.p.k., shuma 10,500 euro*”.

2.14. Ky deklarim nuk mbështetet nga informacioni i marrë nga hetimi administrativ, sipas të cilit për vitin shkollor 2015 – 2016, rezulton e provuar se nëpërmjet transfertave bankare është transferuar si sponsorizim vlera 6,000 euro, si vijon:

- transfertë e kryer në datën 5.10.2015, urdhëruar nga shoqëria “****” sh.p.k., në shumën 3,000 euro, me përfitues D.M., banka “Societe Generale” në Francë, me përshkrim: *“Sponsorship of the school for the student D.M.”*.
- transfertë e kryer në datën 14.4.2016, urdhëruar nga shoqëria “****” sh.p.k., në shumën 1,200 euro me përfitues D.M., banka “Societe Generale” në Francë me përshkrim: *“Sponsorizim shkolle për studenten D.M.”*.
- transfertë e kryer në datën 29.4.2016, urdhëruar nga shoqëria “****” sh.p.k., në shumën 1,800 euro, me përfituese D.M., banka “Societe Generale” në Francë, me përshkrim: *“Sponsorship of the school for the student D.M.”*.

2.15. Për sa më sipër është konsideruar shuma prej 6000 eurosh në analizën financiare kryer për shpenzimet e shkollimit të vitit 2015 –2016, pavarësisht se nuk është provuar forma e duhur ligjore për sponsorizimin nga shoqëria “****” sh.p.k., referuar nenit 2 të ligjit nr. 7892, datë 21.12.1994, “Për sponsorizimet” sipërcituar.

2.16. Në datën 8.9.2015 vajza e subjektit, D.M., ka depozituar *cash* shumën 4,500 euro në llogarinë e saj pranë bankës “Societe Generale” në Shqipëri, me përshkrim: *“D.M. të ardhura nga kursimet”*, shumë e cila është transferuar⁴ brenda ditës në favor të llogarisë së saj pranë bankës “Societe Generale” në Francë me përshkrim: *“Living cost during the studies”*.

2.17. Në dosjen e ILDKPKI-së kopja e mandatit të depozitimit të shumës 4,500 euro ka një shënim me shkrim dore *“sponsorizim për shkollën e mbesës time D.M. nga të ardhurat e mia financiare B.M.*, shënim i cili nuk është në përputhje me parashikimet ligjore të legjislacionit bankar të identifikimit të klientit dhe deklarimit të burimit të depozitimit.

2.18. Për sa kohë depozitimi i shumës 4,500 euro, i datës 8.9.2015 nga vajza e subjektit të rivlerësimit, ka përshkrimin: *“të ardhura nga kursimet”*, nuk ka asnjë dokumentacion ligjor apo financiar me vlerë provues, i cili vë në dyshim pronësinë e këtyre likuiditeteve, ndaj ato janë llogaritur në analizën financiare të vitit 2015, si shpenzime të mbuluara nga subjekti i rivlerësimit. Shënimi me shkrim dore *mbi mandat*, për sa nuk është në përputhje me parashikimet ligjore të legjislacionit bankar, nuk ka vlerë provuese në këtë proces.

2.19. Komisioni përgatiti analizën financiare për vitet 2013-2016, duke vlerësuar në funksion të kryerjes së një procesi të rregullt, që garanton të drejtat e palës dhe në zbatim të parimit të proporcionalitetit e objektivitetit, të konsiderojë në analizën financiare, skenarin më favorizues dhe garantues për subjektin e rivlerësimit, nëpërmjet përfshirjes në këtë analizë edhe të vlerave provuar se janë paguar me mandat bankar nga shoqëria “****” sh.p.k, pavarësisht mungesës së formës së tyre ligjore, sipas nenit 2 të ligjit nr. 7892, datë 21.12.1994, “Për sponsorizimet”.

2.20. Nga analiza financiare për vitet 2013-2016 rezultoi se subjekti i rivlerësimit kishte pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për mbulimin e shpenzimeve gjatë viteve të shkollimit të vajzës përkatësisht në vitin 2013 në shumën - 93,634 lekë; në vitin 2014 në shumën -1,065,795 lekë; në vitin 2015 në shumën - 190,708 lekë; në vitin 2016 në shumën - 468,645 lekë, duke rezultuar me balancë negative totale për 2013 - 2016, prej **1.818.782** lekësh.

2.21. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, subjektit iu kalua barra e provës, me qëllim që të paraqiste shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e këtij rezultati negativ financiar.

2.22. Subjekti i rivlerësimit, me shpjegimet pas rezultateve të hetimit, ka paraqitur aktekspertimin kontabël, nga kontabli i miratuar M. R., me dëshmi nr. 823, datë 23.10.2000, regjistruar me NIPT ***, i cili është hartuar mbi:

- rezultatet e hetimit për subjektin e rivlerësimit znj. Lindita Male (Ziguri);
- metodikën e përdorur në analizën financiare për subjektin e rivlerësimit;

⁴ Sipas konfirmimit bankar në dosjen e ILDKPKI-së, f. ****.

iii) deklaratën noteriale, datë 16.12.2020, të shtetasit B. M., vëllai i bashkëshortit të subjektit;

2.23. Aktekspertimi kontabël, nga kontabli i miratuar M. R., ka kryer rillogaritjen e shpenzimeve të shkollimit për vajzën e subjektit të rivlerësimit, duke konsideruar të ardhura nga sponsorizimi nga xhaxhai B. M., dhe shoqëria “****” sh.p.k. me ortak të vetëm B. M., për studime për vitet 2013; 2014; 2015 dhe 2016.

2.24. Duke u mbështetur në deklaratën noteriale të shtetasit B. M., aktekspertimi, për periudhën 2013 –2016 ka llogaritur se për vitin 2013 rezulton balancë negative në vlerën -372,584 lekë; për vitin 2014, balancë negative në vlerën -515,268 lekë; për vitin 2015 balancë negative në vlerën - 43,027 lekë; dhe për vitin 2016, balancë pozitive në vlerën 107,819 lekë.

2.25. Kjo llogaritje i referohet deklaratës noteriale datë 16.12.2020, ku shtetasi B. M, deklaroi se: “*Kam kontribuar për mbulimin e shpenzimeve të shkollimit të mbesës plotësisht në tre vitet e para 2013 – 2016 dhe pjesërisht në vitin e katërt 2016 – 2017*”. Me përjashtim të shumës 4,500 euro derdhur *cash* në datën 8.9.2015, deklaruesi nuk përmend termin **sponsorizim**, por *kontribut për mbulimin e shpenzimeve, financim etj.* Ky deklarim bie ndesh me deklaratimet e subjektit në deklaratimet periodike, përshkrimin e transfertave e referimin e ekspertit kontabël.

2.26. Në vlerësim të dokumentacionit dhe provave të përdorura për analizën financiare të kryer në aktekspertim nuk janë marrë në konsideratë deklaratimet periodike vjetore, të kryera nga subjekti i rivlerësimit, për periudhën 2013 – 2016 dhe legjislacioni përkatës mbi deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe nëpunësve publikë.

2.27. Analiza është bazuar vetëm mbi shumën e pretenduar të sponsorizuar dhe jo mbi të gjithë dokumentacionin financiar dhe ligjor të subjektit të rivlerësimit për periudhën 2013 – 2016, pasi në të mungon analiza e gjendjeve në llogaritë bankare dhe *cash*, shumat e dokumentuara të shpenzuara dhe mënyra e transferimit të fondeve, analizimi i dokumentacionit të shpenzimeve mbi qiratë/kostot e jetesës në Francë, etj.

2.28. Analiza financiare e paraqitur në aktekspertimin e paraqitur si provë është jo e plotë dhe konkluzionet nuk janë bazuar mbi mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe familjarëve të saj për kryerjen e shpenzimeve të realizuara për periudhën 2013 – 2016, nga burime të ligjshme të dokumentuara.

2.29. Për sa më sipër, analiza financiare e paraqitur në aktekspertimin e paraqitur si provë nuk arriti të provojë të kundërtën mbi balancën negative për vitet 2013-2016 prej **-1.818.782** lekësh.

2.30. Subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e deklaratimit të pasaktë, lidhur me deklarinimin e shpenzimeve të shkollimit të vajzës dhe ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, pasi nuk arriti të provojë se mbulonte me të ardhura nga burime të ligjshme shpenzimet për periudhën 2013 – 2016, duke rezultuar me balancë negative prej -1.818.782 lekësh, duke u ndodhur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” dhe nenit 61, pika 3 të ligjit nr. 84/2016.

II. DEKLARIMI I BASHKËSHORTIT TË SUBJEKTIT

3. Lidhur me apartament banimi *, me sip. 137.9 m², në rrugën “****”, Tiranë** deklaruar në deklaratën *Vetting* nga personi i lidhur: “*Apartament banimi *** në rrugën ‘**** me sip. 137.9 m² ndërtuar nga shoqëria ‘****’ sh.p.k. në përdorim familjar dhe pa qira nga viti 2007 pronë e ‘****’ sh.p.k. dhe ‘****’ sh. a., regjistruar në regjistrin hipotekor të ZVRPP-së Tiranë me nr. ***, datë 26.6.2007, me nr. pasurie, ***, z. k. *****”.

3.1. Subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti nuk kanë deklaruar të drejtat reale mbi këtë pasuri në asnjë nga deklaratat periodike vjetore të viteve 2006 – 2016.

3.2. Subjekti ka paraqitur me përgjigjen e pyetësorit standard edhe një kontratë të panoterizuar huapërdorjeje të datës 10.2.2007 midis palëve “****” sh.p.k., dhe shtetasit F.M., i cili nuk është në përputhje me faktet e rezultuara nga hetimi administrativ, për sa nga verifikimi në QKB

rezulton se nga 16.2.2004 – 1.7.2008, nuk i takojnë vetëm ortakut B.M., por të dy ortakëve, në raport me pjesët e kuotave që zotërojnë në kapitalin themeltar.

3.3. Leja e ndërtimit nr. 273, datë 20.9.2005 rezulton në emër të dy subjekteve investitore ndaj duhet të merrej edhe pëlqimi nga shoqëria tjetër investitore për huadhënien e kësaj prone ndaj shtetasit F.M., për sa kohë nuk ka marrëveshje mbi ndarjen e pronave mes shoqërive.

3.4. **Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në paragrafin 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës**, subjektit iu kalua barra e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me dyshimet se subjekti është përpjekur të fshehtë këtë pasuri, pasi nga hetimi ka rezultuar se:

i) ajo dhe bashkëshorti e kanë përdorur këtë apartament që nga janari i vitit 2007, pa kundërshtpërblim dhe pa ndërprerje;

ii) subjekti nuk e ka deklaruar në asnjë nga deklaratimet periodike vjetore prej vitit 2007-2016 këtë huapërdorje në afat të gjatë të këtij apartamenti;

iii) shpjegimet se kjo pasuri në huapërdorje është pronë e shoqërisë “****” sh.p.k., nuk provohen nga dokumentacioni ligjor provues, pasi rezulton se ky apartament është gjithashtu edhe në pronësi të shoqërisë “****” sh.a.;

iv) shpjegimet e subjektit se ortaku i vetëm dhe përfaqësues ligjor i huadhënësit është vëllai i bashkëshortit, nuk provohen me dokumentacion ligjor provues për sa edhe shoqëria “****” sh.p.k., gjatë viteve të huapërdorjes 2004 – 2008, ka qenë edhe në pronësi të ortakëve të tjerë;

v) subjekti dhe bashkëshorti e kanë përdorur këtë apartament edhe përpara nënshkrimit të kontratës së huapërdorjes, pasi kontrata e energjisë është hapur në emër të bashkëshortit nga viti 2006;

3.5. Në përgjigje të barrës së provës subjekti ka shpjeguar se: *“Në lidhje me këtë pronë të regjistruar në emër të ‘****’ sh.p.k. dhe ‘****’ sh.a., në regjistrin hipotekor në ZVRPP-në Tiranë me nr. ***, datë 26.6.2007, me nr. pasurie ***, z. k. ***, pohoj përdorimin familjarisht dhe pa kundërshtpërblim nga janari i vitit 2007 e në vazhdim.*

Për përdorimin e apartamentit nuk kemi bërë deklarime në deklaratimet periodike, pasi një kërkesë e tillë nuk kërkohet në formularin e deklaratimit. Gjithashtu, ligji nr. 9049 datë 10.4.2003, “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, neni 4, pika a dhe neni 21 përcakton si detyrim për të deklaruar vetëm pasuritë në pronësi ose në bashkëpronësi të subjektit të deklaratimit apo personit të lidhur.

3.6. Shpjegimet e dhëna nga subjekti pas kalimit të barrës së provës, sipas të cilave huapërdorja nuk kërkohet në formularin e deklaratimit, nuk janë në përputhje me parashikimet ligjore në nenin 4, germa “a”, nenet 21 dhe 22 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, ku konkretisht në pikën 1, germa “a”, përcaktohet se duhen deklaruar “pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to”.

3.7. Referuar jurisprudencës të Gjykatës së Lartë, posedimi bën pjesë në të drejtat reale e në kontekstin e detyrimit ligjor të deklaratimit të pasurisë, deklarimi i saj përbënte detyrim për t’u zbatuar nga subjekti i rivlerësimit për vitet 2007 - 2016.

3.8. Faktet dhe provat e administruara gjatë hetimit dhe shqyrtimit administrativ, provojnë se: (i) ekziston marrëdhënia e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj me apartamentin për shkak të përdorimit pa kundërshtpërblim, në mënyrë të pandërprerë, të qetë dhe për një kohë të gjatë të këtij apartamenti; (ii) marrëdhënia e shoqërive ndërtuese me këtë apartament nuk krijon bindjen se ato janë pronarët *de facto* të këtij apartamenti duke pasur parasysh se: (1) ato nuk e kanë përdorur asnjëherë këtë apartament dhe nuk e kanë vendosur kolateral për të siguruar asnjë nga marrëdhëniet e tyre të huamarrjeve me bankat e nivelit të dytë; (2)

deklarimet e subjektit se apartamenti ishte lënë në përdorim nga shoqëria “****” sh.p.k., vinin në kundërshtim me sa rezultoi nga hetimi administrativ, pasi apartamenti ishte gjithashtu edhe në pronësi të shoqërisë “****” sh.a. ; (3) deklarimi i subjektit se ortaku i vetëm dhe përfaqësuesi ligjor i huadhënësit ishte vëllai i bashkëshortit nuk u provuan me dokumentacion ligjor për sa shoqëria “****” sh.p.k., gjatë viteve të huapërdorjes 2004 – 2008, ka qenë edhe në pronësi të ortakëve të tjerë;

3.9. Nga analiza e fakteve dhe rrethanave të referuara më lart, sjellja/marrëdhënia e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit me apartamentin me sip. 137.9 m², në rrugën “****”, Tiranë është si të ishin pronarë të tij.

3.10. Si konkluzion, mosdeklarimi nga subjekti dhe bashkëshorti i të drejtave reale mbi këtë pasuri në deklaratat e pasurisë, ndër vitet, 2007-2016 e vendosin subjektin në kushtet e deklarimit të pasaktë, në kundërshtim me parashikimin e nenit 33, pika 5, germa “a”, e ligjit nr. 84/2016.

3.11. Subjekti i rivlerësimit nuk arriti t’i provojë trupit gjykues të kundërtën e rezultateve të hetimit, lidhur me dyshimet mbi pronësinë e vërtetë të këtij apartamenti.

4. Lidhur me detyrimet e bashkëshortit të subjektit

4.1. Bashkëshorti i subjektit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* detyrimet si vijon:

a) aktdetyrimi për kreditim afatgjatë për investime, datë 12.9.1994, me BKT-në (sipas emërimit të asaj kohe) në shumën 2,000,000 lekë, me afat 3-vjeçar; me interes 32% me bazë vjetore. Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur e pashlyer 1,000,000 lekë;

b) huamarrje nga të tretë për qëllim të aktivitetit privat të ushtruar në vitet 1993 dhe 1994. Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur e pashlyer 16,100,000 lekë.

4.2. Komisioni kërkoi informacion pranë ATK-së, e cila ka konfirmuar se: “Për shtetasin F. S. M. i datëlindjes **** me nr. personal *** sqarojmë sa më poshtë: ‘ në emër të F. S.M. rezultojnë tri kredi të transferuara nga ish-Banka e Kursimeve Përmet nga të cilat njëra i është akorduar z. F.M.dhe dy të tjerat që i janë akorduar z. G.I., me vendim nr. **, datë 29.3.2002, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet është bërë zëvendësimi i debitorit G.I. me debitorin e ri F.S.M.. Detyrimi aktual i debitorit F.S.M.. për të tria kreditë është **23,898,154 lek.**”

Detyrim ligjor	Monedha	Kredia I	Kredia II (ish G. I)	Kredia III (ish G.I.)	Totali
Principal	lekë	1,400,000	1,000,000	2,910,000	5,310,000
Interes	lekë	5,665,210	4,009,934	8,981,210	18,656,354
Shpenzime të pafalshme	lekë	24,000	3,500	4,300	31,800
Arkëtime	lekë	100,000	0	0	100,000
Total	lekë	6,989,210	5,013,434	11,895,510	23,898,154

4.3. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në paragrafin 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës subjektit iu kalua barra e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën, për sa duket se shpjegimet e subjektit për huamarrjet të cilat vijnë të jenë aktuale, si dhe përdorimin e tyre dhe gjendjen e tyre apo marrëveshjet e arritura me palët huadhënëse nuk provohen me dokumentacion ligjor.

4.4. Subjekti ka shpjeguar se: “... lidhur me huat e bashkëshortit të marra në vitet 1993 dhe 1994, sikurse kam shpjeguar nuk kam pasur njohje me huadhënësit dhe asnjë lloj komunikimi personal. Në dijeninë time të prejardhur nga bashkëshorti, huat janë përdorur për qëllimet e biznesit dhe huadhënësit kryesisht miqësi, shoqëri, krushqi me bashkëshortin, i kishin të ardhura nga puna në emigracion ...”

... në lidhje me detyrimin për kredinë e marrë në vitin 1994 në ish-BKT e kohës, masa e detyrimit 1,000,000 lekë (një milion), është deklaruar nga bashkëshorti pas zbritjes së shumave këst kredie të paguara në kohën e aktivitetit të para vitit 1995 sipas konfirmave bankare të disponuara prej tij, pasi ishte tërhequr nga fondi kredi vetëm shuma 1,400,000 lekë (një milion e katërqind mijë), sikurse shprehet dhe në kontratë ...

... për sa i përket detyrimeve në ATK në ngarkim të bashkëshortit për arsye zëvendësimi debitori, nuk është bërë një deklaram i tillë për shkak të padijenisë, për të cilin edhe vetë kemi ardhur në dijeni me vonesë.

Pasi kemi mësuar se zëvendësimi është bërë mbi bazën e një vendimi të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, gjyqtarit A. Sh. në një proces gjyqësor të zhvilluar në vitin 2002 në mungesë të bashkëshortit, kemi pretendimet tona, pasi zëvendësimi lidhet për kredi të marra nga paditësi G. B, rreth viteve '96, në kohën kur bashkëshorti nuk kryente asnjë aktivitet tregtar që t'i nevojitej përdorimi i fondeve kredi të marrë prej tij. Pasi të njihemi me dosjen civile dhe të mundësojmë dokumentacionin e plotë, do ndjekim rrugët ligjore të rishikimit të vendimit civil.”

4.5. Në deklaramin për herë të parë, subjekti nuk deklaroi detyrime financiare ndaj personave juridike dhe fizikë, ndërsa bashkëshorti, ndër të tjera, deklaroi detyrime të prapambetura të mbyllura në bilancin e vitit 1994, Përmet në vlerë 17,000,000 lekë, ndërsa në arsye të krijimit të detyrimit bashkëshorti i subjektit ka deklaruar nga aktiviteti tregtar i vitit 1993-1994.

4.6. Në procesverbalin e datës 21.3.2016, në ILDKPKI⁵, subjekti i rivlerësimit⁶, në lidhje me deklaramin në deklaratën për herë të parë të detyrimeve të prapambetura të mbyllura në bilancin e vitit 1994 Përmet, ndaj Bankës së Kursimeve dhe klientëve në vlerën 17.000.000 lekë (rideklaruar në vitin 2006), ndër të tjera, është përgjigjur se: “... sqaroj se ky detyrim ka qenë ndaj bankës Kombëtare Tregtare...dhe ndaj disa personave të ndryshëm”.

4.7. Bazuar në të dhënat e pasqyruara në pasqyrën e llogarive vjetore (gjendjet financiare) për periudhën 1.1.1994 – 31.12.1994 (bilancin kontabël)⁷, të shoqërisë “****” sh.p.k., rezultoi se kërkesa për arkëtim nga debitorët në aktiv të bilancit paraqiten në vlerën 3,000,000 lekë, ndërsa në detyrime të kërkueshme pas më shumë se një vit: hua nga bankat dhe institucionet e kreditit vlera e pasqyruar 1,400,000 lekë; hua të tjera në vlerën 1,520,000 lekë.

4.8. Gjithashtu, në DPV-të për vitet 2004 dhe 2005, subjekti nuk ka deklaruar në lidhje me pasuri, të ardhura apo detyrime të bashkëshortit (përfshirë edhe detyrimet e sipërpërmendura).

4.9. Në DPV-në e vitit 2006, subjekti në detyrime financiare ndaj personave juridike dhe fizikë, ndërmjet të tjera, deklaroi : “Detyrim tatimor të planifikuar për licencën e shoqërisë ‘****’ sh.p.k. Përmet. në shumën 320,000 lekë, datë fillimi shkurt 2006 dhe datë mbarimi 31.12.2006 (pa deklaruar shlyerje nga deklarami i mëparshëm deri më 31.12.2006). Detyrime të tjera të prapambetura 16.1 milion lekë të kreditorëve dhe 1 milion të Bankës së Kursimeve (viti 1994), në vlerë totale 17.1 milion lekë (pa deklaruar shlyerje nga deklarami i mëparshëm deri në datë 31.12.2006), ndërsa në DPV-në 2007, subjekti dhe/ose bashkëshorti nuk kanë deklaruar detyrimet financiare gjendje në datën 31.12.2007”.

4.10. Në analizë të shpjegimeve të subjektit dhe të dokumentacionit ligjor provues, të paraqitur gjatë hetimit administrativ se për sa u përket huave të pretenduara të marra për ushtrimin e aktivitetit tregtar, konkretisht si administrator/ortak i shoqërisë “****” sh.p.k., ato nuk janë evidentuar dhe pasqyruar në llogaritë vjetore të kësaj shoqërie (gjendjet financiare) për periudhën 1.1.1994 – 31.12.1994, me datë mbyllje më 31.3.1995.

⁵ Shkresë nr.*** prot., datë 19.5.2020, të ILDKPKI-së.

⁶ Pyetje nr. 1.1.

⁷ Bilanci kontabël për periudhën 1.1.1994 – 31.12.1994, i shoqërisë “****” sh.p.k., dorëzuar nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 2.

4.11. Sa më sipër, subjekti nuk ka arritur të provojë pretendimet e saj në lidhje me qëllimin e marrjes së këtyre huave (biznesin), ndonëse për një pjesë të tyre subjekti ka përcjellë dokumentacion lidhur me kontratat, përsëri nuk është dokumentuar ecuria e detyrimeve/huave të marra, si dhe shumat që janë shlyer apo marrëveshje të lidhura dhe në ç'periudhë kohore.

4.12. Në lidhje me mënyrën e deklarimit të detyrimeve/huave, në nenin 4 të ligjit nr. 9049/2003 i ndryshuar, është parashikuar detyrimi i subjekteve deklaruese në kuptim të këtij ligji, (konkretisht subjektet e përcaktuara në nenin 3 të tij), detyrohen të deklarojnë në ILDKPKI, brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë: [...] dh) *detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, të shprehura në lekë ose në valutë të huaj; [...].*

4.13. Subjekti nuk i ka deklaruar këto hua/detyrime në DPV-në e vitit 2007 dhe në vazhdim, ndonëse ky detyrim ligjor ka qenë i përcaktuar edhe në formularin përkatës të deklaratës ku janë përfshirë *detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë (kredi, huamarrje, detyrim për studime etj.) që ekzistojnë brenda dhe jashtë vendit, të mbetura ende pa u shlyer për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 dhjetor të vitit të deklarimit, si dhe detyrimet e lindura gjatë vitit të deklarimit. Detyrime këto të zyrtarit, bashkëshortit/es dhe fëmijëve në moshë madhore...*

4.14. Subjekti nuk ka deklaruar saktë këto hua/detyrime as në deklaratën *Vetting*, ndonëse ky detyrim ligjor ka qenë i përcaktuar edhe në formularin përkatës të deklaratës, për të cilin subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj duhet të merrnin masat për të deklaruar gjendjen reale të detyrimeve në kohën e plotësimit të deklaratës.

4.15. Pretendimi i subjektit mbi padijeninë e gjendjes reale të detyrimeve në kohën e plotësimit të deklaratës nuk mbështetet nga sa, sipas informacionit në faqen zyrtare të QKB-së, bashkëshorti i subjektit në datën 28.6.2016 ka kërkuar personalisht pezullimin e shoqërisë, duke u njohur rrjedhimisht në këtë datë me detyrimet reale të shoqërisë. Subjekti nuk arriti të provojë qëllimin e marrjes së këtyre huave, saktësimin e shumës së huas, ecurinë referuar legjislacionit përkatës.

4.16. Për sa më sipër, subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e deklarimit të pasaktë, referuar nenit 33, pika 5, germa "a", të ligjit nr. 84/2016, lidhur me deklarimin e detyrimeve.

5. Në lidhje me aktivitetin tregtar të shoqërive "**" sh.p.k. dhe "****" sh.p.k. bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në paragrafin 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës,** subjektit iu kalua barra e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën, për sa ka rezultuar se ka:

i) mosdeklarim të të ardhurave nga punimet, ndërtimi, sipërmarrja e shoqërisë "****" sh.p.k. për periudhën 2005 – 2007, arkëtimi dhe transferimi në llogarinë personale të personit të lidhur të shumave me prejardhje nga aktiviteti;

ii) mosprovim me dokumentacion ligjor të deklarimit të subjektit për kthimin e pretenduar të të ardhurave të marra nga shtetasi R.K., iu kthye nga shoqëria, pa provuar se si u transferuan këto të ardhura nga administratori te shoqëria;

iii) paraqitur shpjegime lidhur me transaksionin e kryer nga personi i lidhur/F.M. në llogari të shoqërisë "****" sh.p.k.

5.1. Subjekti ka shpjeguar se: *"Shoqëria '***' sh.p.k. me NIPT *** nuk ka zhvilluar asnjëherë aktivitet për ndërtimin e objektit shtesë pallati *** rruga '*** me lejen e ndërtimit nr. **** datë 20.12.2004, me vendim të KRRT-së nr. ***, datë 28.5.2004, të nxjerrë në emër të subjektit ndërtues '***' ndërtuar në fakt ***kate. Objekti është ndërtuar tërësisht nga shoqëria '***' sh.p.k., me administrator G. D.*

Nga shoqëria '***' sh.p.k., nuk është bërë asnjë blerje materiali, nuk janë kryer pagesa etj., që lidhen me punime të kryera në objektin në rrugën '***', fakt që konfirmohet dhe nga dokumentacioni i mbajtur nga organet tatimore.

Sipas raportit të kontrollit me datë 16.5.2007, të Degës së Tatim Taksave Përmet, nga ana e subjektit disponohej vetëm një kontratë bashkëpunimi me sipërmarrje në ndërtim, si dhe leja e ndërtimit nga Bashkia Tiranë (formulari nr. 4) e dhënë në emër të shoqërisë '***' sh.p.k.. Në faqen e fundit të titulluar 'Vlerësimi i situatës tatimore', thuhet se nga ana e subjektit nuk disponohej dhe nuk ishte kryer asnjë shitje deri në datën e kontrollit (raport kontrolli me datë 16.5.2007, f. 1, mbajtur nga Dega e Tatim Taksave Përmet).

Administratori i shoqërisë '***' sh.p.k., G. D., është dhe personi që ka aplikuar në emër të tij në dhjetor 2006 për nxjerrjen e lejes së legalizimit, aplikim i bërë fshehtas bashkëshortit, i cili dijeninë e ka marrë rastësisht vite më vonë nga banorët e pallatit. Në lidhje me objektin është nxjerrë leja e legalizimit nr. ***, datë 12.6.2018, në favor të subjektit '***' sh.p.k., me përfaqësuese ligjore vajzën e G. D. (E. D.).

Shoqëria '***' sh.p.k., me NIPT ****, nuk ka realizuar të ardhura dhe nuk ka kryer shpenzime, ndaj dhe nuk janë pasqyruar deklarime në deklaratën Vetting dhe në deklaratat periodike.

Për sa i përket pasaktësisë në kontratën e sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 1.11.2006, lidhur me lejen e ndërtimit që paraqitet si e nxjerrë në emër të shoqërisë së bashkëshortit, është lapsus nga ana e noteres. Këtë e provon dhe fakti se bashkëlidhur kontratës së sipërmarrjes është dokumenti leje ndërtimi, në emër të shoqërisë '***' sh.p.k., me të njëjtat ekstremitete si ato në kontratën e sipërmarrjes përveç emrit të subjektit që është nxjerrë (vendim nr. ***, datë 28.5.2004, i KRRT-së pranë Bashkisë Tiranë në emër të subjektit ndërtues '***' sh.p.k., formulari nr. 4).

Shuma 40,000 euro (dyzetë mijë) që përmendet në kontratë nuk është dorëzuar nga shtetasi R. K.. Shuma 99,000 euro (nëntëdhjetë e nëntë mijë) që përbën fondin e kredisë të tërhequr nga R. K., transferuar në datën 12.1.2007, në llogari personale të bashkëshortit dhe kthyer po atë ditë këtij personi, nuk u përdor asnjëherë në funksion të aktivitetit ndërtues. Ky fakt përkon dhe me përgjigjen në shkresën nr. *** prot., datë 27.10.2020, të 'ABI Bank' që përmend llogari rrjedhëse kredie në euro në datën 11.1.2007 (ish ***) *** me kredimarrës R. K. dhe bashkëkredimarrëse bashkëshorten e tij B. K..

Pavarësisht se transferimi është bërë në llogari personale të bashkëshortit, qëllimi i shumës ka qenë për aktivitetin e shoqërisë dhe, si e tillë, ka qenë detyrim i tij për ta deklaruar në organet tatimore dhe jo në deklaratën si person i lidhur, pasi nuk është e ardhur apo shpenzim. Mandati për kthimin mbrapsht të shumës mbart vulën e shoqërisë së bashkëshortit.

Lidhur me deklaratën noteriale nr. ***rep., nr. *** kol., datë 15.3.2016, të bërë rreth 9 vite më vonë nga R. K., shpjegohet me faktin se si bashkëshorte e F. M., në atë kohë erdha në dijeni kur jam pyetur në ILDKPKI. Pas informacionit të marrë në ish-NBG (dega tek ***) se anulimi i kontratës së sipërmarrjes ishte bërë de facto, i kërkova bashkëshortit që një deklaram i tillë të bëhej para noterit.

Në lidhje me shumën 700,420 lekë (shtatëqind mijë e katërqind e njëzet), të derdhur në datën 4.5.2012, në llogari të shoqërisë '*** sh.p.k.', është e pavërtetë që transaksioni është kryer nga bashkëshorti. Punonjësi i ish-NBG Bank, sot 'ABI Bank', ka hedhur të dhëna jo të sakta në sistemin elektronik të bankës, për transaksionin nr. ***, datë 4.5.2012. Nga përgjigja e 'ABI Bank' me datë 4.12.2020, dhe ballafaqimi me kopjen fizike të transaksionit të kryer me mandatin me datë 4.5.2012, rezulton se derdhja nuk është bërë nga bashkëshorti F.M., por nga F.S.M. Sipas të dhënave në QKB ky person, i panjohur prej nesh, është administrator i shoqërisë '*** sh.p.k., me NIPT ***, themeluar në datën 13.4.2012.

*Për të provuar shpjegimet lidhur me transaksionin në shumën 700,420 lekë pranë 'ABI Bank', subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës: përgjigjen e 'ABI Bank' me datë 4.12.2020, ekstrakt nga QKB-ja (të dhëna të printuara) të shoqërisë '*** sh.p.k., me administrator F.M.'.*

5.2. Shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit pas rezultateve të hetimit bien në kundërshtim me deklarinimet që ka bërë në përgjigje të pyetësorit nr. 2⁸, ku konkretisht është shprehur se: *"pas një periudhe 10-vjeçare në gjendje pasive shoqëria '*** sh.p.k., me NIPT ***', ka riçelur aktivitetin në korrik të vitit 2005, me lidhjen e një marrëveshjeje me shtetasin G. D., administrator i firmës së ndërtimit '***' sh.p.k. Aktiviteti është çelur me qëllim ndërtimin e një shtese pallati ekzistues **në rrugën '*** nga firma '***' sh.p.k., me lejen e ndërtimit nr. ***, datë 28.5.2004, ku shoqëria '*** sh.p.k., do të menaxhonte aktivitetin. Në kohën e riçeljes së aktivitetit punimet e shtesës kishin ngecur në soletën e katit të dytë. Bazuar në pikën 6 të marrëveshjes, shoqëria '****sh.p.k., do t'i siguronte mjetet financiare nëpërmjet një kredie që do të merrej nga Banka Popullore, e cila nuk u miratua. Në pritje të aprovimit të kësaj kredie, i vetmi aktivitet i shoqërisë '*** sh.p.k., ishte një kontratë porosie me një individ për blerjen e dy ambienteve në objektin e ndërtuar me lejen nr. ***, datë 28.5.2004, por edhe kjo u anulua me marrëveshjen e palëve për arsye personale të porositësit dhe shuma është rikthyer. Anulimi është bërë nga vetë porositësi në kohën e disbursimit të kredisë së marrë prej tij në shumën 99,000 euro në ish-NBG, për qëllime të kësaj kontrate...",* çka dëshmon se bashkëshorti i subjektit ka ushtruar aktivitet pas vitit 2005.

5.3. Referuar dokumentit "raport kontrolli"⁹, datë 16.5.2007, të Degës së Tatim Taksave Përmet, ka rezultuar se subjekti "****" sh.p.k., sipas dokumentacionit në dosjen përkatëse dhe NIPT-it të marrë ushtron aktivitetin e tij në ndërtimin e një objekti për shërbime dhe banimi në rrugën "****", Tiranë, që nga gusht i vitit 2005 dhe në vazhdim...

5.4. Gjithashtu, nëpërmjet procesverbalit nr. 142/2 prot., datë 11.5.2007, nga organi tatimor është evidentuar parregullsi në mospasqyrim të veprimeve ekonomike të kryera në ndërtimin e një ndërtese me destinacion banimi, si dhe mosdeklarimi i FDP-ve respektive dhe mosderdhja e detyrimeve tatimore e kontributeve të sigurimeve sipas legjislacionit në fuqi... Këtë procesverbal e ka nënshkruar edhe administratori i kësaj shoqërie, z. F.M..

5.5. Duke analizuar shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, si dhe dokumentacionin ligjor të disponuar, kam vlerësuar se organi tatimor vërteton ushtrimin e një aktiviteti privat për periudhën 2005 – 2007, nga shoqëria e përfaqësuar nga z. F.M.. Bashkëshorti i subjektit, me nënshkrimin e procesverbalit sa më sipër, ka pranuar ushtrimin e aktivitetit, shkeljet e konstatuara dhe penaltitetet përkatëse.

5.6. Nga subjekti i rivlerësimit nuk është provuar që bashkëshorti të ketë kundërshtuar raportin e kontrollit dhe/ose rezultatet e nxjerra¹⁰ nga shkeljet e konstatuara në këtë kontroll (nëpërmjet ankimit në DPT dhe/ose në Gjykatë).

5.7. Në kontratën e porosisë (me objekt kontrate porosi për ndërtim apartament banimi) nr. ***, datë 1.11.2006, lidhur ndërmjet shoqërisë "*****" sh.p.k., përfaqësuar nga administratori dhe ortaku i vetëm F.M., me cilësinë e sipërmarrësit dhe z. R.K., me cilësinë e porositësit, është përcaktuar se¹¹: *neni 2 - pala sipërmarrëse, shoqëria "****e" sh.p.k. merr përsipër ndërtimin dhe shitjen në favor të porositësit z. R. K., dy apartamente, kati i parë dhe kati i dytë me struktura (***) me sipërfaqe 125 m² secili...; -neni 3 (çmimi) -... 3.1 porositësi do të blejë apartamentet e mësipërme kundrejt çmimit 900 euro/m² dhe në total prej 225,000 euro; 3.2 kjo shumë do të paguhet nga porositësi me këste të përcaktuara si vijon: (i) sot në datën e lidhjes së kësaj kontrate nga porositësi z. R.K., është shuma 40,000 euro, pagesë e cila do të*

⁸ Përgjigje të pyetjes nr. 2.

⁹ Dosja e ILDKPKI-së, f. ***.

¹⁰ Njoftim vlerësimi tatimor nr. ***, datë 21.5.2007, i Degës së Tatimeve Përmet.

¹¹ Neni 2 dhe 3.

pasqyrohet me mandatpagesë; (ii) pjesa tjetër e detyrimit do të likuidohet në momentin e akordimit të kredisë nga banka në të cilën do të aplikojë për kredi porositësi...

5.8. Gjithashtu subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka bashkëlidhur, ndërmjet të tjera, edhe: (i) mandatpagesë nr. 25, datë 12.1.2007, të shoqërisë “****” sh.p.k., ku shtetasit R.K. i është paguar shuma 99,000 euro, me përshkrim “për anulim kontrate e porosisë pallati Ali Demi; (ii) mandatpagesë e NBG-së, datë në të cilën z. F.M. tërheq shumën 99,000 euro nga llogaria nr. **** në euro në emër të tij në këtë bankë; (iii) deklaratë noteriale nr. ***, datë 15.3.2016, e shtetasit R.K., i cili deklaron se: “.në muajin dhjetor të vitit 2006, unë kam lidhur një kontratë porosie për apartament banimi dhe dyqan në shumën 99,000 euro, me shoqërinë “****e” sh.p.k., përfaqësuar nga administratori i kësaj shoqërie F.M. Në muajin janar të vitit 2007, unë e kam zgjidhur kontratën e porosisë ... duke marrë nga administratori i shoqërisë F.M. shumën 99,000 euro, kjo e shoqëruar me mandatpagesën me nr. *** datë 12.1.2007”.

5.9. Për sa më sipër ka mospërputhje në vlerën e pretenduar të paguar dhe të rikthyer nga/për shtetasin R.K., pasi referuar kontratës çmimi i apartamenteve ka qenë në shumën 225,000 euro, në datën e nënshkrimit të kontratës (1.11.2006) është paguar nga porositësi shuma 40,000 euro dhe në datën 12.1.2007, në llogarinë e z. F.M. në “NBG bank” është kredituar shuma 99,000 euro, nga llogaria e shtetasit R.K., shumë të cilën z. F.M.e ka tërhequr brenda ditës.

5.9.1. Në total për administratorin e shoqërisë “****” sh.p.k. është dokumentuar se u dha nga porositësi vlera prej 139,000 eurosh (40,000 +99,000). Referuar kontratës kjo shumë është përfituar individualisht nga sipërmarrësi dhe kjo nuk është deklaruar/pasqyruar në DPV-të përkatëse vjetore.

5.9.2. Subjekti i rivlerësimit pretendon që shuma 99,000 euro e paguar nga porositësi në datën 12.1.2007, në llogarinë e z.F.M. në “NBG bank” i është rikthyer me mandatpagesë shtetasit R. K. brenda së njëjtës datë 12.1.2007, duke sjellë si rezultat që në të njëjtën ditë të jenë kryer tri transaksione në vlera të konsiderueshme, që kanë kthyer çdo gjë në gjendjen fillestare. Nëse z. R.K. nuk ka qenë dakord me sipërmarrësin, nuk kishte pse të transferonte shumën 99,000 euro (të përfituara nga kredia në “NBG bank”) në llogari të z. F.M. i cili ia riktheu në të njëjtën ditë nga shoqëria e tij porositësit.

5.10. Ndonëse nga subjekti i rivlerësimit pretendohet që shuma 99,000 euro i është rikthyer me mandatpagesë shtetasit R.K., brenda datës 12.1.2007, duket e pakuptimtë se pse në të njëjtën ditë u kthye çdo gjë në gjendjen fillestare.

5.11. Në këtë rast, dokumentimi i një kontrate të nënshkruar me marrëveshje dhe vullnet të plotë para noterit, e cila ka përcaktuar kushtet e sipërmarrjes, çmimin dhe likuidimin e tij, detyronte palët të dokumentonin edhe revokimin e kësaj kontrate sipërmarrjeje dhe kthimin e pagesës si çmim të pasurisë.

5.12. Në vlerësim të kushteve të kontratës, nënshkruar me marrëveshje dhe vullnet të plotë para noterit, z. F.M.ka pranuar se ka arkëtuar në vitin 2006 vlerën prej 40,000 euro, të cilat nuk janë dokumentuar si të kthyera porositësit.

5.13. Në analizë të shpjegimeve dhe të dokumentacionit ligjor provues subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën e barrës së provës dërguar me rezultatet e hetimit lidhur me: (i) mosushtrimin e aktivitetit të ndërtimit, si dhe mos realizimin e të ardhurave të bashkëshortit nga ky aktivitet për periudhën 2005 – 2007; (ii) mosdokumentim të revokimit të kontratës së porosisë me shtetasin R.K.dhe kthimin e shumave të paguara nga ai..

5.14. Për sa më sipër, subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e deklaramit të pasaktë, referuar nenit 33, pika 5, germa “a” të ligjit nr. 84/2016, lidhur me deklaramin mbi të ardhurat dhe aktivitetin e bashkëshortit të saj.

Nisur nga sa më lart analizuar, për kriterin e kontrollit të pasurisë kam votuar kundër konfirmimit në detyrë të subjektit të rivlerësimit, Lindita Ziguri (Male), pasi kam vlerësuar se

subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ndodhen në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, duke bërë të zbatueshëm nenin D, pikat 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, nenin 33, pika 5, gjerat “a”, “b”, “c”, si dhe nenin 61, pika 3 të ligjit nr. 84/2016.

Xhensila PINE

Relatore/Kundër